



Çka duhet të dini për liberalizimin e vizave?

- Ju do të **mund të qëndroni pa vizë deri në 90 ditë** (në një periudhë 180 ditëshe) në zonën Shengen.
- Për hyrje pa vizë **ju duhet pasaporta biometrike** (e vlefshme për të paktën 3 muaj pas datës kur synoni të largoheni nga shteti i BE-së të cilin po e vizitoni).
- Ju **nuk kenë automatikisht të drejtë** të hyni në zonën Shengen.
- Zyrtarët e kufirit në shtetet e BE-së mund të **kërkojnë dokumente shtesë që e arsyetojnë** qëllimin dhe kushtet e qëndrimit të synuar (p.sh. dëshmi të akomodimit, kthimit ose biletën kthyesë) dhe dëshmi për mjete të mjaftueshme financiare.
- **Shtetet e zonës Shengen:**
Austria, Belgjika, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Italia, Letonia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, dhe Zvicra. Bullgaria, Kroacia, Qiproja dhe Rumania gjithashtu do ta zbatojnë regjimin pa viza. Megjithatë, me liberalizimin e vizave, nuk mund të udhëtoni në Spanjë.

Për më shumë informata, ju lutem vizitoni: www.mei-ks.net





Çka duhet të dini për liberalizimin e vizave?

- Nuk duhet **ta tejkaloni qëndrimin 90 ditor** (brenda një periudhe prej 180 ditësh) në zonën Shengen.
- Nuk ju mundëson të **kërkoni azil në asnjë shtet** brenda zonës Shengen.
- Nuk ju mundëson të **punoni në zonën Shengen**.
- Për të studiuar në një shtet të zonës Shengen, **ju duhet viza studentore e lëshuar nga autoritetet e shtetit përkatës**.
- Policia Kufitare **mund të mos ju lejojë të hyni nëse nuk i përmbushni kushtet e hyrjes ose kushtet për udhëtim pa viza**.
- Keqpërdorimi dhe qëndrimi përtej kohës së paraparë **mund të gjobiten dhe të kenë si rezultat dëbimin dhe ndalimin e hyrjes** në zonën Shengen deri në 5 vjet.
- BE-ja mund ta rivendosë regjimin e vizave për kosovarët nëse vërehet një numër i madh i shkeljeve të kushteve për udhëtim pa viza.

Për më shumë informata, ju lutem vizitoni: www.mei-ks.net

